

**Tony B. Watlington Sr., Ed.D.**  
Superintendent

1 Prill, 2024

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

**Jam i gëzuar të njoftoj se regjistrimi për Programet Verore të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias është tashmë i hapur për nxënësit në kopshtin e fëmijëve deri në klasën e 12-të. Klikoni [here /ketu](#) të regjistroheni sot!**

Programet verore të këtij viti përfshijnë programe të reja emocionuese të tilla si “Career dhe Technical Educational Middle School Summer Camp” dhe “Summer Achievers”. Programet tona verore ofrojnë mjedise argëtuese dhe të sigurta për studentët për të ruajtur dhe avancuar arsimimin e tyre. Programi veror gjithashtu ndihmon të rinjtë tanë të ruajnë aftësitë kritike që mësuan gjatë vitit shkollor.

Programi gjithëpërfshirës ofron mundësi për studentët e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias të të gjitha moshave – nga pasurimi me bazë mësimi deri te mundësitë e punësimit veror për nxënësit e shkollave të mesme. Përveç kësaj, “City of Philadelphia’s Office of Children and Families” po ofron programin veror të plotë ditor përmes një nisme të re, “Summer Achievers” dhe Drejtorja Arsimore e Filadelfias ofron komponentin akademik të programit brenda “Summer Achievers”. Për të mësuar më shumë rreth programeve të ndryshme që janë në dispozicion dhe për t'u regjistruar, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të programeve verore [here](#).

Të gjithë studentët aktualë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, përfshirë ata që hyjnë në kopshtin e fëmijëve në vjeshtë, kanë të drejtë dhe inkurajohen të regjistrohen për programet verore. Vendet në programet verore janë të kufizuara dhe regjistrimi nuk garanton pranimin. Regjistrimi për shumicën e programeve hapet më 1 Prill dhe mbyllet më 10 Maj. Familjet dhe studentët do të njoftohen për statusin e tyre të regjistrimit deri më 31 Maj. Ju lutemi rishikoni informacionin specifik të programit [here](#).

Shpresoj se do ta konsideroni [registering today/regjistrohuni sot](#) për t'i dhënë fëmijës tuaj një mundësi për të shijuar një përvojë të pasur dhe kuptimplote verore. Regjistrimi për shumicën e programeve është i hapur tani deri më 10 Maj, por ju lutemi kontrolloni [Summer Programs website](#) për detajet e programit dhe informacionin e kontaktit.

Programi veror është një nga mënyrat me të cilat Drejtorja Arsimore po vepron sipas angazhimit për t'i përgatitur fëmijët tanë për të imagjinuar dhe realizuar çdo të ardhme që dëshirojnë.

Në partneritet,

*Tony*

Tony B. Watlington Sr., Ed.D.

Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias